



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	05-09	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org/Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKM/SHK	5156/2022		1/4	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.667/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi Bajraktari dhe Arditë Haxhnikaj-Demi - anëtarë, si dhe Sabile Avdyli -Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.667/2022 të datës 27.07.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë fshati kundër organit të punësimit Komuna e Gjakovës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe të Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 05.09.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.667/2022 e datës 27.07.2022 e parashtruar nga ankuesi**

**II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 29.06.2022 i nxjerr nga Menaxheri i Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës.**

**A r s y e t i m**

Ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur për pozitën e punës Specialist i Prokurimit Publik me numër reference RN00008899 në Komunën e Gjakovës.

Menaxheri i Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin e datës 23.06.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN0005470 të ankuesit me arsyetimin se i njëjta nuk i ka plotësuar kushtet e konkursit për pozitën përkatëse të punës, pasi që ankuesi nuk posedon përvojën e punës në fushën për të cilën zhvillohet procedura.

Kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit, ankuesi me datë 25.06.2022 ka parashtruar ankesë të Njësia për Burime Njerëzore në Komunë e Gjakovës. Kjo e fundit me Vendimin e datës 29.06.2022 ka refuzuar ankesën e ankueses si të pa bazuar.

Ankuesi me datën 27.07.2022 ka parashtruar ankesën me numër të protokollit 4337/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 29.06.2022 të Menaxherit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 01.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Gjakovës, ndërsa kjo e fundit me datë 10.08.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokollit 4831/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave për vendosje meritore ka administruar këto prova:** Ankesën me numër të protokollit 4337/2022 të datës 27.07.2022 me numër A.nr.667/2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Diplomë e datës 06.01.2014 me nr.469/14 e lëshuar nga Kolegji Iliria; Diplomë e shkollës së mesme; kopja e letërnjoftimit; Çertifikatë e datës 29.01.2021 e lëshuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë; Çertifikatë themelore profesionale për prokurim 2021-2023 nr.843; Letër reference e datës 09.11.2020; Vërtetim i datës 03.12.2018; vërtetim i datës 26.06.2014 i Komunës së Gjakovës; Dëshmi e aplikimit për regjistrim në vitin e parë master -viti akademik 2013-2014; Vërtetim i datës 12.03.2015; Çertifikatë e trajnimit me kompjuter; Letër reference e datës 12.04.2021; Vendim i datës 29.06.2022 i lëshuar nga Menaxheri i Personelit në Komunën e Gjakovës; Vendim i datës 23.06.2022 i Menaxheri i Personelit në Komunën e Gjakovës; Përgjigje në ankesë e datës 10.08.2022 nga organi i punësimit me numër protokollit 4631/22 bashkë me shkresat e lëndës; Kopja e konkursit e datës 01.06.2022-12.06.2022; Vërtetim i datës 26.06.2014; Vërtetim i datës 11.03.2019; Vërtetim i datës 03.12.2018; Mirënjohje nga organi shqyrtues i prokurimit; Lista e Aplikantëve në SIMBNJ; Dokumenti i vlerësimit paraprak i datës 23.06.2022; Vendimi i datës 23.06.2022 ,Ankesë e datës 25.06.2022; lista e ngushtë përfundimtare e datës 29/06/2022 Vendimi i datës 29.06.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të provave të lëndës, konstatoi se ankesa e ankuesit është e pabazuar, **SEPSE:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës është konstatuar së më datë 29.04.2022 në Sistemin Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) është shpallur njoftimi lidhur me hapjen e konkursit për pozitën e punës "Specialist i prokurimit publik" me numër reference RN00008899, në Komunën e Gjakovës. Konkursi në fjalë ka qenë i hapur nga data 01.06.2022 deri me datë 12.06.2022, dhe si kritere të përgjithshme formale kanë qenë të përcaktuara:

**Arsimi i kërkuar:** Diploma e studimeve universitare në Ekonomi, Biznes dhe Juridik me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to. (Në rastin kur kredit janë mbledhur si pasojë e diplomës Bachelor dhe Master, fusha e diplomës master të jetë be njëjtë apo vazhdim i diplomës Bachelor);

*Përvoja e punës: së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës.*

Sipas shkresave të lëndës rezultojnë se ankuesi ka aplikuar në konkursin e shpallur për pozitën e punës "Specialist i Prokurimit Publik" me numër reference RN00008899 në Komunën e Gjakovës, mirëpo Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore, në fazën e shqyrtimit paraprak të aplikacioneve, me Vendimin e datës 23.06.2022 ka refuzuar aplikacionin me numër RAN0005470 të ankuesit me arsyetimin se i njëjti nuk ka plotësuar kushtet për pozitën përkatëse të përvojës së punës, pasi që ankuesi nuk posedon përvojën e punës siç kërkohet në konkurs *së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lire të punës*, poashtu ankuesit me bazë të njëjte edhe përmes vendimit të datës 29.06.2022 i nxjerr nga Njësia Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës i është refuzuar edhe ankesa e parashtruar kundër vendimit për refuzimin e aplikacionit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i është bërë e pa drejtë nga Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit për pozitën e punës "Specialist i Prokurimit Publik" nga se i njëjti konsideron se i plotëson kushtet sa i përket këtij konkursi dhe poashtu deklaroi se i ka 26 muaj punë praktike si dhe 14 muaj si zyrtarë dhe se është i vetëdijshëm se nuk e ka përvojën e përgjithshme në prokurim publik, i njëjti në lidhje me këto pretendime ka ofruar edhe provat që janë administruar në shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave lidhur me pretendimet ankimore të ankuesit ka shqyrtuar shkresat e lëndës një nga një dhe gjitha së bashku dhe rrjedhimisht ka konstatuar se ankuesi ka përfunduar studimet themelore me datë 06.01.2014 në drejtimin juridik, dhe posedon këtë përvojë pune sipas vërtetimit të datës 26.06.2014 ka ndjekur trajnimin në Drejtorinë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë prej datës 04.11.2013 e deri më datën 25.06.2014; Sipas vërtetimit të datës 12.03.2015 është angazhuar me marrëveshje për shërbime të veçanta në Komunën e Gjakovës nga Ministria e Diasporës nga data 25.06.2014 -26.02.2015 pozitën Zyrtar për hartimin dhe përditësimin e regjistrit të Diasporës dhe Mërgatës, sipas vërtetimit të datës 03.12.2018 ka dëshmuar se ka kryer stazhin e praktikantit të avokati G.G në Gjakovë prej datës 02.12.2017-01.12.2018 dhe sipas letër referencës të datës 09.11.2020 me të cilën dëshmohet se nga data 03.03.2020 deri më datën 03.09.2020 ka qenë i angazhuar në pozitën asistent i Kryetarit të Organit Shqyrtues i prokurimit dhe sipas letër referencës të datës 12.04.2021 me të cilën dëshmohet se nga data 07.09.2020 deri më datën 07.03.2021 ka qenë i angazhuar si praktikant në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Andaj, bazuar si me sipër Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave vlerëson se ankuesi me rastin e aplikimit për pozitën përkatëse të punës, ku afati i aplikimit ishte nga data 01.06.2022 deri me datë 12.06.2022 nuk ka ofruar dëshmi të mjaftueshme që vërtetojnë përvojën e punës sipas kriterit të konkursit, fakt i konfirmuar edhe nga vetë ankuesi sipas kësaj ankese, andaj mbi këtë bazë Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave konstaton se pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara dhe rrjedhimisht vlerëson se Njësia për Burime Njerëzore, në Komunën e Gjakovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 29.06.2022 për refuzimin e ankesës ka konstatuar drejtë dhe në mënyrë të plote gjendjen faktike dhe rrjedhimisht drejtë ka zbatuar ligjin material, duke vepruar



kështu ne përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-144 për Zyrtaret Publikë, dhe Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda, A.nr.667/2022, datë 05/09/2022.

Sabile Avdyli

*Sabile Avdyli*

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit



**Vendimi i dërgohet;**

- ❖ Ankuesit
- ❖ Kryetarit të Komunës së Gjakovës;
- ❖ Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës; dhe
- ❖ Arkivit të KPMSHCK-së.

